

# ÇFARË DUHET TË DIMË PËR DHUNËN SEKSUALE DHE TË BAZUAR NË GJINI NË KUSHTE TË KRIZËS



## **Çfarë duhet të dimë për dhunën seksuale dhe të bazuar në gjini në kushte të krizës**

Kjo broshurë u dedikohet të gjithë ofruesve të shërbimeve (punëtorëve shëndetësor, punëtorëve social, psikologëve, policisë), organizatat humanitare dhe vullnetarë, të cilët janë inkuadruar në ballafaqimin me krizat humanitare.

Broshura është përpiluar në bashkëpunim me grupin punues për përgatitjen e procedurës standarde operative për dhunën e bazuar në gjini në situata krize, me mbështetje të zyrave të UNFPA në Shkupi.

## Dhuna e bazuar në gjini – korniza ndërkombëtare

**Dhuna e bazuar në gjini (DHBGJ)** ka të bëjë me cilindo akt të dëmshëm kundër vullnetit të personit, që është bazuar në dallimet e caktuara sociale mes meshkujve dhe femrave. Përfshinë lëndim fizik, seksual ose mental (dhunë) ose vuajtje, kërcënime të këtij lloji, detyrim dhe privimi nga liria.

### Llojet/kategoritë e dhunës së bazuar në gjini

- 1. Dhunimi:** penetrimi jo vullnetar (pa pëlqim) i pa miratuar në vagjinë, anus ose gojë me penis ose cilëndo pjesë të trupit. Përfshinë edhe penetrim në vagjinë ose anus me objekt.
- 2. Shqetësimi, sulmi seksual:** cilido akti kontaktit seksual pa pëlqim, që nuk rezulton ose përfshinë penetrim. Për shembull, përpjekje për dhunim, puthja pa dëshirë, ledhatimi ose prekja e gjenitaleve ose të pasmet. Saktimi gjenital femëror është akt i dhunës që ndikon te organet seksuale dhe si i tillë, duhet të kualifikohet si shqetësim seksual. Ky tip, nuk nënkupton përdhunim, ku ndodh penetrimi.
- 3. Dhuna fizike:** akt i dhunës fizike, që nuk është e natyrës seksuale. Për shembull, goditja, shuplaka, mbytja, prerja, shtyrja, djegia, të shtënit ose përdorimi i cilitdo tip të armës, jo rehati ose lëndim. Ky tip nuk përfshinë sakatim gjenital femëror.
- 4. Martesa e dhunshme:** martesë, kundër vullnetit të personit. Me këtë nënkuptohen edhe martesat nën moshën madhore, të cilat janë martesat të moshës nën 18 vjet.
- 5. Keqtrajtimi psikologjik/emocional:** shkaktimi i dhimbjes ose lëndimit mental ose emocional. Për shembull: kërcënime me dhunë fizike ose seksuale, frikësimi, përlulja, izolimi me dhunë, përcjellje, shqetësim, kujdes i padëshiruar, komente, gjeste ose fjalë të shkuara me përmbajtje seksuale ose frikësimi, shkatërrimi i gjërave të vlefshme personale.
- 6. Tregtia me njerëz dhe eksploatimi seksual:** kombinim i tipave të ndryshëm të DHBGJ, që shpesh intensifikohen gjatë krizës.



## Pse në situata krize rritet rreziku prej dhunës së bazuar në gjini?

Gjatë krizës dhe gjendjeve të krizës, shumë faktorë kontribuojnë që të rriten rreziqet dhe ndjeshmëria e qytetarëve, veçanërisht femrat, lidhur me dhunën e bazuar në gjini.

### Disa nga faktorët dhe rreziqet janë:

- ◆ Shpërngulja
- ◆ Mungesa e resurseve themelore në bashkësi
- ◆ Mungesa e mbrojtjes në dhe prej bashkësisë
- ◆ Servise të çrregulluara shoqërore
- ◆ Infrastrukturë e çrregulluar ose e dobësuar
- ◆ Norma të ndryshuara kulturore dhe gjinore
- ◆ Militarizim i rritur
- ◆ Përdorimi i keqtrajtimit seksual dhe përdhunimi si armë për luftim.

## Cilët persona janë më të ndjeshëm ndaj dhunës seksuale dhe të bazuar në gjini gjatë krizës dhe situatave të krizës?

- ◆ Vajzat në moshën adoleshente
- ◆ Persona të mitur të cilët janë pa shoqërim
- ◆ Amvisëritë në krye të cilave qëndron grua
- ◆ Meshkuj dhe femra në moshë më të vjetër
- ◆ Persona të cilët i përkasin pakicave etnike/religjioze
- ◆ Persona me pengesa fizike ose intelektuale
- ◆ Persona me gjendje specifike shëndetësore (sëmundje serioze, ISP/HIV-SIDA, shtatzënia dhe dhënia gji)
- ◆ Persona me histori paraprake të dhunës seksuale (si viktimë dhe/ose dëshmitar, duke përfshirë edhe martesën në moshë të hershme).





## **Cilët janë faktorët më të rëndësishëm të rrezikut për ekspozim ndaj dhunës seksual dhe të bazuar në gjini?**

### **Faktorët e rrezikut për dhunën e bazuar në gjini lidhur me kontekstin e personit:**

- ◆ Mungesa e prezencës së mashkullit (i cili do të siguronte mbrojtje, trashëgimin e të drejtave, pranim shoqëror nga ana e bashkësisë)
- ◆ Mungesa e familjes / lidhje në bashkësi
- ◆ Mungesa e mjeteve financiare
- ◆ Mospasja e mundësisë për plotësimin e nevojave themelore (ushqim, ujë, higjienë, sende personale, ëndrra etj.)
- ◆ Mungesa dhe/ose humbja e dokumenteve juridike (lidhur me identitetin personal, t qenit prind, prona etj.).

## Faktorët e rrezikut për dhunën e bazuar në gjini lidhur me ambientin e jashtëm:

- ◆ Mungesa e qasjes deri te informatat
- ◆ Mënyra e pasigurt e transportimit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:
  - Transporti në mjete publike të ngarkuara si trena dhe autobusë, pa mbikëqyrje;
  - Transport në mjete private transporti pa mbikëqyrje, siç është transporti me taksi;
  - Transporti jo legal, si për shembull kontrabanda
  - Kalimi i segmenteve të caktuara në këmbë, pa mbikëqyrje
- ◆ Keqpërdorimi i autoritetit (privimi nga liria në mënyrë jo të drejtë, pamundësia e ndihmës juridike dhe tjera)
- ◆ Siguria e pamjaftueshme në Qendrat transite dhe Qendrat për refugjatë, duke mos u kufizuar në:
  - Vende të ngarkuara
  - Vende të errëta dhe të izoluara
  - Mungesa e shërbimeve/kapaciteteve për meshkuj, gra, fëmijë dhe persona me nevoja të veçanta (tualetë, vendi për gjumë, vendi për distribuim të ushqimit dhe regjistrimi)
  - Mungesa nga mbikëqyrja në të gjitha vendet
  - Sjellja joadekuate nga ana e personelit humanitar, duke përfshirë edhe shqetësimin seksual dhe keqpërdorimin.

## Si të njoh se personi është viktimë e dhunës së bazuar në gjini?

Gratë dhe vajzat marrin ushqim, ujë, shprehin turp të marrin peceta higjienike ose mjete tjera higjienike, refuzimin e vendosjes së kontaktit me sy, shikimi në dysheme ka gjasa më të mëdha të ndodh te viktimat e dhunës së bazuar në gjini dhe te ata individë të cilët janë nën rrezik. Është e rëndësishme që këto mesazhe të transmetohen sa edhe të ketë mungesë të përgjigjes nga pala tjetër.

Viktimat e dhunës së bazuar në gjini të cilat ballafaqohen me stres akut dhe të cilat kanë nevojë për ndihmë të parë psikologjike mund t'i kenë këto shenja dhe simptoma:

- ◆ Dridhje, dhimbje koke, ndjenjë e lodhjes së madhe, humbja e oreksit, dhimbje e përgjithshme e trupit;
- ◆ Të qarit, pikëllim, disponim depresioni, keqardhje;
- ◆ Anksiozitet, frikë;
- ◆ Të qëndrosh "gati";
- ◆ Brengosje se do të ndodh diçka e keqe;
- ◆ Pagjumësi, ëndrra të këqija;
- ◆ Hidhërim, tërbim;
- ◆ Faj, turp;
- ◆ Huti, pandjeshmëri emocionale, ndjenjë joreale ose trullosje;
- ◆ Duket si i tërhequr ose tërësisht i shtangur (nuk lëviz);
- ◆ Nuk u përgjigjet të tjerëve, nuk flet aspak, i çorientuar (për shembull nuk e di emrin e tij, prej nga është ose ku gjendet);
- ◆ Nuk mund të kujdeset për veten ose për fëmijët (për shembull, nuk mund të ha ose të pi, nuk mund të sjell vendime të thjeshta).



Viktima e dhunës së bazuar në gjini që ka nevojë për ndihmë të parë psikologjike **me siguri nuk do të kërkojë kurrfarë ndihme.**



## Si mund t'u ndihmohet viktimave të dhunës së bazuar në gjini?

Shumë e rëndësishme është që të gjithë të cilët ofrojnë ndihmë të dinë t'i njohin simptomat e stresit akut dhe të veprojnë. Në raste të këtilla të gjithë personat të cilët ofrojnë ndihmë, duhet t'i identifikojnë **nevojat themelore dhe/ose urgjente** – duke përfshirë edhe ato çështje të cilat mund të duken të vogla ose sekondare, por viktimi i percepton si urgjente dhe themelore dhe ndaj tyre duhet t'u përgjigjet në kohë. Këto do t'u ndihmojnë viktimave që:

- ◆ Ta rritin besimin ndaj atyre të cilët ofrojnë ndihmë;
- ◆ Të njihen nevojat e vërteta;
- ◆ Të bëhen më të vetëdijshëm për rrethinën dhe burimet e mundshme dhe llojet e mbështetjes që janë të kapshme.

Ofroni shoqërim (sipas kërkesës) deri te shërbimet të cilat janë të kapshme në vend:

- ◆ Klinika/ambulanca mobile gjinekologjike;
- ◆ Ndihma e parë psikologjike (punëtorë terreni, OJQ të specializuara/personal në thirrje)
- ◆ Personeli për mbrojtje (UNHCR/persona tjerë nga organizatat humanitare)

Në rast ku ka rast të identifikuar të dhunës së bazuar në gjini, ofruesit e ndihmës duhet ta marrin parasysh t'i ofrojnë viktimës të shoqërohet deri te vendi ku mund të ketë kontroll mjekësor ose ku mund të flasë me psikologun.



Me ata individë të cilët janë më të goditur ose ata të cilët nuk janë të gatshëm të kërkojnë ndihmë, disa hapa mund të ndihmojnë të “thyhet akulli”, veçanërisht nëse kjo përfshinë edhe disa **lëvizje**:

- ◆ “Pas aq kohë udhëtimit dhe motin e keq mund të dehidrosh. Ec të shkojmë t pimë ujë. Ec të shkojmë të marrim ndonjë krem ushqyese ose balsam për buzët”
- ◆ “A do të kishit dëshiruar rroba të rreja për ju ose për fëmijët tuaj? Ec të shkojmë t’i marrim bashkë”
- ◆ “Çfarë prisni këtu? Dëshironi të shkojmë bashkë deri...?”



## Respektoni dëshirat, burimin, të drejtat dhe dinjitetin e viktimës:

- ◆ Këshillohuni me viktimën për atë se ku dëshiron t kërkojë ndihmë dhe respektoni dëshirat e tij/saja. Mos e orientoni, mos i sugjeroni ose në çfarëdo mënyre mos ndikoni;
- ◆ Punëtorët shëndetësor, punëtorët social dhe psikologët të cilët janë pjesë e ekipeve të terrenit në qendrat transitore janë persona adekuat për zhvillimin e bisedës dhe intervista me personat nën rrezik nga dhuna e bazuar në gjini;
- ◆ Bisedat, intervistat dhe hulumtimet me personat nën rrezik gjithmonë duhet t'i zhvilloni në kushte që sigurojnë privatësi;
- ◆ Për bisedat, hulumtimet dhe intervistat me persona nën rrezik/viktima, gjithmonë angazhoni personel dhe përkthyes nga gjinia e njëjtë si edhe viktima, ose në pëlqim me dëshirën e viktimës;
- ◆ Kini respekt dhe mbani qasje neutrale. Mos u qeshni dhe mos tregoni çfarëdo mosrespektimi ndaj personit, kulturës së saj/tij, familjes ose situatës;
- ◆ Jini të durueshëm; mos bëni presion për më tepër informata nëse viktima nuk është a gatshme që të japë lidhur me përvojën e saj/tij;
- ◆ Asnjëherë mos bëni presion për zbulimin e tërësishëm të rastit të dhunës – parashtroni vetëm pyetje relevante. (Për shembull, statusi për virgjërinë e viktimës nuk është relevante dhe nuk duhet të diskutohet);
- ◆ Shmanguni të kërkonin nga viktima që t'i përsëritë informatat në më shumë intervista.
- ◆ Udhëhiquni nga parimi i jo diskriminimit gjatë çdo bisede me viktimat dhe gjatë ofrimit të gjitha shërbimeve.





МИНИСТЕРСТВО ЗА ЗДРАВСТВО  
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



Х. Е. Р. А.  
Асоцијација за здравствено образование и информирање

A Member Association of  
 **IPPF** International  
Planned Parenthood  
Federation  
European Network

Ky publikim është mbështetur nga UNFPA. Qëndrimet dhe mendimet e shprehura në këtë publikim u takojnë autorëve dhe nuk do të thotë se janë reflektim i UNFPA, Fondit për Popullatë të Kombeve të Bashkuara.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

364.633:316.346.2(497.7)

ЌFARË duhet të dimë për dhunën seksuale dhe të bazuar në gjini në kushte të krizës. -  
Shkup : Asociacionit për edukim shëndetësor dhe hulumtim H.E.R.A., 2016. - 12 стр. ; 21 см

ISBN 978-608-4598-56-5

a) Сексуално и родово nasилство - Македонија

COBISS.MK-ID 101348874

Botues: HERA - Asociacionit për edukim shëndetësor dhe hulumtim

Përkthyer nga: Gramoz Shabani

Radhitja grafike: Grigor Unkovski

Shtypi: Steda Grafika

Tirazhi: 1500 ekzemplarë